



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E KULTURËS

## KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

### VENDIM

Nr. 12, dt.08.01.2016

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 08.01.2016, pasi shqyrtoi kërkesën për licensim në fushën e restaurimit për ark. *Odhise Zoto*,

### VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për pajisje me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë AP. “**Projektim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës**”, me nënkategorinë AP/2, AP/3, sipas rregullore “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit” të ark. *Odhise Zoto*.
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, pajisjen e ark. *Odhise Zoto*, me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë AP. “**Projektim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës**”, me nënkategorinë AP/2, AP/3.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI